

251 ORGANIZIMI DHE KLASIFIKIMI I MATERIALEVE

Fusha përmban të dhënat për organizimin dhe klasifikimin e materialeve brenda një koleksioni si dhe të dhënat për pozitën e njësisë në hierarkinë e përshkrimit arkivor.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
251		Organizimi dhe klasifikimi i materialeve	r
	a	<i>Organizimi</i>	r
	b	<i>Klasifikimi</i>	r
	c	<i>Niveli</i>	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

251a Organizimi

Mënyra, në të cilën materiali i përshkruar është ndarë në njësi më të vogla, p.sh. koleksioni në grupe, grupet në nëngrupe.

251b Klasifikimi

Shprehjet, me të cilat është përshkruar mënyra e klasifikimit të materialeve në njësi (sipas radhës alfabetike, kronologjike etj.).

251c Niveli

Shprehja, me të cilën identifikohet pozicioni i materialeve të përshkruara në tërë hierarkinë e përshkrimit.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

001d *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Niveli hierarkik*

Kodi tregon nëse regjistrimi është i lidhur në mënyrë hierarkike me regjistrimet e tjera dhe cila është pozita e tij në hierarkinë e përshkrimit.

SHEMBUJ

1.

200	1□	a Николай II, император. 1868-1918 j 1860-1991
251	□□	a2 описи c Фонд <i>(Koleksioni i letrave të carit rus Nikolaj II., të ndara në dy grupe.)</i>

2. * COBISS.net

200	1□	a Trashëgimia e Lasgush Poradecit j 1920-1987
251	□□	c Fondi a Trashëgimia është organizuar në 10 grupe

200	1□	a Letërkëmbimi j 1920-1987
251	□□	c Grupi b Letrat janë klasifikuar sipas radhësalfabetike të dërguesve <i>(Trashëgimia e Lasgush Poradecit është përshkruar në regjistrimin për koleksionet. Fondi në tërësi është i ndarë në 10 grupe, të cilat janë përshkruar në detaje në regjistrimet e veçanta. Një nga grupet është letërkëmbimi i Lasgush Poradecit. Në regjistrimin për letërkëmbimin, në fushën 251 vendoset shënimi se letërkëmbimi është klasifikuar sipas radhës alfabetike.)</i>